

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

PËR PROGRAMIN E STUDIMIT
“MASTER I SHKENCAVE
NË KËSHILLIM PSIKOLOGJIK”

OFRUAR NGA ALBANIAN UNIVERSITY

Ekspert i vlerësimit të jashtëm
Prof. Dr. Nikoleta Mita



Korrik, 2016

Përmbajtja e raportit

1. Tabelë përmbledhëse për programin
2. Hyrje
3. Misioni/ objektivat e programit
4. Struktura akademike e fakultetit që përgjigjet për programin e studimit
5. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit
6. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit
7. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare
8. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
9. Programi i studimit, organizimi i tij
10. Mësimdhënia
11. Studentët
12. Kërkimi shkencor
13. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun
14. Analiza përmbledhëse për implementimin e programit të studimit
15. Rekomandime
16. Shtojca

Tabelë përmbledhëse

Për Programin e studimit MSH në Këshillim Psikologjik

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit të IAL	VKM Nr. 197, datë 10.04.2004
4	Titulli i programit të studimit:	MSH në Këshillim Psikologjik
5	Cikli i studimit:	I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Privat Albanian University
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Institucionet që bashkëpunojnë për praktikën
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Nuk aplikohet
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Nuk aplikohet
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Shtatë
15	Aktivizimi i programit të studimit	Licensimi: Urdhër Nr. 498, datë 18.10.2012
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	Korrik 2014

HYRJE

Ky raport përmban gjetjet dhe analizën e vlerësimit të jashtëm të kryer në kuadrin e kërkesës së Albanian University drejtuar APPAL për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e parë të programit të studimeve.

Albanian University është një institucion i krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 10.04.2004. Ky universitet ofron programe në të trija ciklet e studimit. Ky universitet është në proces për akreditimin institucional.

Më 31.08.2016 në APAAL ka ardhur nga Universiteti Privat Albanian University shkresa me Nr 189/1 Prot, datë 31.08.2016 "Përgjigje për Draft - Raportin e programit të studimit Master i Shkencave në "Këshillim Psikologjik". Pas njohjes me Komentet nga ky Institucion mbi Draft RVJ, Ekspertja e Vlerësimit të Jashtëm, gjykoj se komentet që paraqet Institucioni nuk sjellin të nevojshëm ndryshimin e Raportit të Vlerësimit.

Baza ligjore e aktivitetit të vlerësimit të jashtëm për programin "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" është:

1. Ligj nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë dhe akte të tjera nënligjore në mbështetje të tij.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 10.04.2004 për licencimin e Albanian University.
3. Urdhër Nr. 498, datë 18.10.2012 për licensimin e programit të studimit MSH në Këshillim Psikologjik.

4. Urdhër nr.134 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve të arsimit të lartë".
5. Udhëzues i APAAL mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Ekspert i vlerësimit të jashtëm për programin "MSH në Këshillim Psikologjik" është Prof. Dr. Nikoleta Mita.

Procesi i vlerësimit të jashtëm

Synimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm ishte përcaktimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për programin "MSH në Këshillim Psikologjik" në kuadrin e kërkesës së AU për akreditimin e këtij programi.

Vlerësimi i jashtëm përfshiu tre veprimtari:

- a) analizë e të dhënave dhe e raportit të vlerësimit të brendshëm të AU;
- b) vizitë në institucion;
- c) hartim i raportit të vlerësimit të jashtëm.

Për hartimin e këtij raporti, vlerësuesi i jashtëm u mbështet në:

- Shqyrtimin dhe analizën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm i Albanian University.
- Shqyrtimin dhe analizën e dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e programit që vlerësohet, të tilla si dokumentacioni pedagogjik i programit të studimit; rregullorja e studimit; dokumentacioni i sekretarisë mësimore, si: regjistri i të dhënave për studentët e regjistruar, regjistri i notave, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, dosjet personale të studentëve; dokumentacioni i zyrës së sigurimit të cilësisë; dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore.
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në Albanian University si dhe në takimet me stafin drejtues të universitetit, pedagogët e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, studentët dhe stafin administrativ.

Gjatë vizitës në institucion u realizuan takime me drejtues të universitetit, Rektoren, dy Zëvendës rektorët, Dekanin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me stafin akademik të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, me studentë, me punonjës të Zyrës së Kurrikulave, me punonjës të sekretarisë mësimore, punonjës të zyrës së burimeve njerëzore, me punonjës të bibliotekës. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset e mësimit të këtij universiteti dhe në bibliotekën e universitetit. Gjatë gjithë procesit të realizimit të vizitave në Albanian University, vlerësuesi i jashtëm u asistua nga punonjës pranë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Angazhimi dhe bashkëpunimi i drejtuesve të Albanian University për ofrimin e informacionit të kërkuar nga vlerësuesi i jashtëm ishte serioz. Të gjitha kërkesat e vlerësuesit të jashtëm lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacionit u plotësuan menjëherë.

Të dhëna për programin e studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik"

Programi i studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" është miratuar të hapet me Urdhër Nr. 498, datë 18.10.2012. Në vitin akademik 2012-2013 ka patur 6 studentë. Në vitin akademik 2013-2014 kanë vazhduar studimet 4 studentë (1 i larguar dhe një mbetës). Në këtë vit akademik nuk ka patur regjistrime të reja. Në vitin akademik 2014-2015 dhe 2015-2016 nuk ka patur regjistrime të reja. Janë diplomuar katër studentë në vitin 2014.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Albanian University ka një plan të zhvillimit strategjik të institucionit për vitet 2013-2017. Programi i studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" është hartuar në përputhje me misionin dhe synimet strategjike të AU dhe ka si qëllim të ofrojë një formim të



specializuar në psikologjinë e këshillimit që do të mundësonte një karrierë profesionale për shërbimet e këshillimit psikologjik në shkolla, kopshte, çerdhe, për orientimin profesional dhe çështje të zhvillimit personal.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Misioni i programit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" është hartuar në përputhje me pikën 1, 2 dhe 4 të misionit të AU të shprehur në dokumentin "Strategjia për zhvillimin institucional në Albanian University 2013-2017" dhe ka si qëllim të përgatisë psikologë këshillimi të cilët do të mund të ofronin shërbime të këshillimit psikologjik.</p> <p>Ky program studimi është hartuar duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut të punës për psikologë këshillimi. Ai i është përgjigjur kërkesës së diktuar për këtë specialitet si rezultat i ndryshimeve sociale dhe problematikave të shfaqura në këto vite të tranzicionit.</p> <p>Programi është ndërtuar duke marrë parasysh kontekstin e zhvillimit social të vendit. Konteksti aktual i zhvillimit të vendit e dikton nevojën e specialistëve të psikologjisë së këshillimit, specialiteti i cili nuk ka ekzistuar më parë në Shqipëri.</p> <p>Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Kjo realizohet përmes përfshirjes në program të lëndëve që adresojnë çështje të vlerave kombëtare, të kultivimit të vlerave, studimit të rasteve që lidhen me zbatimin e vlerave në kontekstin e këshillimit psikologjik.</p> <p>Kjo përputhje evidentohet nëpërmjet krahasimit të misionit dhe objektivave të institucionit me misionin dhe objektivat e programit të marrë në vlerësim të paraqitura në dokumentet e strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe programin e studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik".</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit është përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit, gjë që shihet në disa aspekte: a) programi plotëson synimin për të përgatitur specialistë në këshillim psikologjik; b) programi</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>kombinon standardet akademike me kompetencat profesionale; c) programi kombinon mësimin me kërkimin.</p> <p>Kjo lidhje është e pasqyruar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, pasqyrohet në dokumentin e programit të studimit dhe u konfirmua edhe gjatë takimit të vlerësuesit të jashtëm me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>VJ konstatoi se përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Ky kriter është mbajtur parasysh që në momentin e hartimit të programit të studimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>AU ka parashikuar zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit në dokumentin e strategjisë së zhvillimit 2013-2017. Në këtë universitet funksionojnë dy zyra: Zyra e Kurrikulave dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që kanë përgjegjësinë për relizimin e këtij kriteri. Nga takimi me punonjës të këtyre dy zyrave u konfirmua procedura që ndiqet për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, përfshirë edhe programin që vlerësohet.</p> <p>Dëshmi për relizimin e këtij kriteri ishin raportet semestrale dhe vjetore të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Në këto dukumente analizoheshin çështje të cilësisë së mësimdhënies dhe të arritjeve të studentëve si dhe çështje që lidheshin me programet lëndore.</p> <p>AU, bazuar në raportin e FSHSH dhe të DPP përcakton drejtimet dhe detyrat që duhet të përmbushen për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënit. Zyra e Kurrikulave dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë përgjegjësinë për relizimin e këtij kriteri.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi i studimit "MSH në Këshillim Psikologjik" është ideuar dhe funksionon në përputhje me misionin e AU. Ai përputhet gjithashtu me strategjinë për zhvillim të institucionit (2013-2017). Programi është ndërtuar duke respektuar legjislacionin në fuqi. Organizmat që veprojnë në AU, si Zyra e Kurrikulave dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që kanë përgjegjësinë për relizimin e këtij kriteri, garantojnë zhvillimin dhe përmirësimin e tij në vijimësi në bazë të kërkesave të reja ligjore dhe akademike. Standardet për misionin dhe objektivat e programit përmbushen plotësisht.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përgjigjet për programin "MSH në Këshillim Psikologjik". Sipas Statutit të Universitetit, Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Përgjegjësit e departamenteve. Organ drejtues është Këshilli i Fakultetit. Fakulteti i Shkencave Shoqërore është i organizuar në 4 departamente: Departamenti i Shkencave Juridike; Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës. Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit.

Dokumentacioni nënligjor i AU përmba procedurat e krijimit dhe të funksionimit të organeve drejtuese.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Statuti i AU
 - Rregullore e AU
 - Rregullore e Studimeve
 - Paketa e dokumentacionit të AU
 - Dosja e programit të studimit
 - Programet lëndore
 - Dokumentaioni i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
 - Dokumentacioni administrativ: dokumentacioni i personelit, dokumentacioni i vlerësimeve akademike të studentëve.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>AU është i organizuar institucionalisht në bazë të Statutit dhe të Rregullores së Universitetit. Struktura organizative e lejon të përmbushë misionin e tij.</p> <p>AU ka tre fakultete.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore që përgjigjet për programin që vlerësohet ka katër departamente: Departamenti i Shkencave Juridike; Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>Departamenti Psikologjisë së Përgjithshme që përgjigjet për programin "MSH në Këshillim Psikologjik" ka në përbërje të tij 18 pedagogë efektive, nga të cilët 1 profesor, 1 profesor i asociuar, 6 me gradën doktor, 6 pedagogë në proces doktore dhe 4 pedagogë me gradën master i shkencave. Në këtë departament punojnë edhe 16 pedagogë me kontratë, nga të cilët 1 me titull profesor, 4 profesorë të asociuar, 6 me gradën shkencore "Doktor" dhe 5 në proces doktore. Këto të dhëna janë sipas dokumentit të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore deklaron më shumë anëtarë të DPP sesa janë dhënë në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim	

për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dëshmoi se i përmbush përgjegjësitë që ka për realizimin e programit "MSH në Këshillim Psikologjik". Kjo u pasqyrua në takimin me pedagogët të cilët ishin të informuar, shfaqën përkushtim dhe seriozitet. Por edhe studentët vlerësuan pozitivisht përkushtimin e departamentit për realizimin e programit të studimit dhe komunikimin e pedagogëve dhe të administratës si një pikë të fortë.

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

FSHSH dhe DPP përcaktojnë nevojat për personel akademik si dhe kriteret që duhet të përmbushë personeli që pajtohet në punë në AU dhe kriteret për vlerësimin e performancës së personelit akademik. Kjo u dëshmuar në takimin me anëtarët e DPP dhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Gjithashtu edhe dokumentacioni nënligjor i AU e ka të parashikuar procedurën e rekrutimit të personelit dhe vlerësimin e veprimtarisë së tij.

Konkluzionet e vlerësimit: AU, FSHSH dhe DPP janë të organizuar institucionalisht sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe sipas Statutit dhe Rregullores së AU. Autoritetet drejtuese manifestojnë përgjegjshmëri, seriozitet dhe profesionalizëm. DPP ka një personel të mjaftueshëm në numër dhe me tregues të mirë të kualifikimit dhe të përvojës. Kjo pasqyrohet në titujt, gradat, CV dhe seriozitetin e shfaqur gjatë vizitës në institucion si dhe nga vlerësimet e studentëve. **Standardet përmbushen plotësisht.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ është përzgjedhur në përputhje me kërkesat e programit, kriteret e përcaktuara për specialitetin dhe cilësinë. Performanca e personelit monitorohet dhe vlerësohet sipas plotikës së AU. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka përgjegjësinë për të ndjekur procedurat e monitorimit dhe të vlerësimit të personelit. Nga takimi me personelin dhe shqyrtimi i dokumentacionit, shënojmë se personeli akademik ka tregues mjaft të mirë të cilësisë dhe është i angazhuar tërësisht në plotësimin e misionit të programit.</p> <p>Nga vizita në AU konstatuam se edhe veprimtaria e personelit administrativ përputhej me strategjinë e institucionit dhe mbështeste veprimtarinë e personelit akademik.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik merr pjesë në hartimin e kurrikulave dhe përmirësimin e tyre. Secili anëtar i departamentit propozon ndryshimet dhe përmirësimet e mundshme të programeve lëndore për çdo vit. Personeli akademik i DPP bashkëpunon me Zyrën e kurrikulave për të bërë përmirësimet dhe ndryshimet e programeve lëndore në masën që lejohet.</p> <p>Rekrutimi i personelit bëhet në bazë të politikës së AU e cila përmban kriteret e rekrutimit dhe procedurat e rekrutimit dhe të përzgjedhjes.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>FSHSH ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Në fillim të çdo viti akademik DPP vlerëson nevojat për personel dhe ia paraqet Këshillit të Fakultetit. Këshilli i Fakultetit përcakton kriteret dhe është Komisioni i Vlerësimit ai që ndjek procedurat e përzgjedhjes.</p> <p>Në programin "MSH në Këshillim Psikologjik" në vitin akademik 2015-2016 japin mësim katër pedagogë të brendshëm dhe gjashtë të jashtëm. Kjo dëshmohet nëpërmjet dokumentit të planit mësimor, listës së personelit të ZBNJ dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 40% të personelit akademik. Kërkohej që të përmirësohet ky raport për të përmbushur kriterin 2 të këtij standardi.</p> <p>AU ka një bazë të dhënash për procedurën e rekrutimit dhe të përzgjedhjes së personelit akademik. Këtë bazë të dhënash e disponon ZBNJ. Ndërsa Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mban të dhënat e vlerësimit të performancës së pedagogëve nga studentët dhe drejtuesit.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën</p>	<p>Përgjegjësi i programit mban gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Kriteri 2 nuk respektohet për të gjitha lëndët pasi vetën dy titullarë të lëndëve kanë gradën shkencore "doktor", ndërkohë që të tjerët janë në proces doktorature.</p> <p>Ky kriter nuk aplikohet për masterin e shkencave.</p>

<p>shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Të gjithë autoritetet drejtuese të AU, FSHSH dhe DPP janë të punësuar me kohë të plotë. Kjo dëshmohet nga dokumentacioni që ka ZBNJ e AU.</p> <p>AU ka personel të mjaftueshëm për të mbikëqyrur praktikën profesionale. DPP ka 34 pedagogë, një numër i mjaftueshëm për të udhëhequr studentët në praktikë, pasi numri total i studentëve të programit që vlerësohet është 6.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>DPP zotëron dokumentacion për udhëheqjen e tezës së diplomës dhe listën e udhëheqjeve.</p> <p>Udhëheqësit kanë grada dhe tituj.</p> <p>DPP ka përcaktuar se një pedagog mund të udhëheqë 5 studentë.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Pedagogët e miratuar si udhëheqës shkencorë kanë formim dhe specializim në fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Kjo dëshmohet nga CV, lëndët që zhvillojnë dhe lista e udhëheqjeve.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve</p>	<p>Personeli ndihmës është në dispozicion të studentëve të programit të këshillimit psikologjik, duke u asistuar atyre veçanërisht për përdorimin e teknologjisë elektronike për qëllime të punimeve shkencore.</p>

<p>laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>AU ka siguruar bashkëpunimin e personelit akademik, ndihmës dhe administrativ për përmbushjen e objektivave të programit. Kjo dëshmohet me faktin se secili ka detyra të caktuara për të përmbushur misionin e programit. Ky bashkëpunim u vu në dukje nga pedagogët dhe studentët e intervistuar.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>AU ka përcaktuar ngarkesën mësimore në orë për pedagogët duke përfshirë në ngarkesë dy komponentë: ngarkesën mësimore dhe ngarkesën për udhëheqjen e punimeve të diplomës.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe DPP kanë informacionin e plotë për anëtarët e personelit akademik që janë përfshirë në përmbushjen e misionit të programit të studimit që është marrë në vlerësim. Dosjet e personelit akademik përmbajnë informacionin për të dhënat personale, për formimin dhe kualifikimin, për veprimtarinë kërkimore dhe botuese. Po ashtu AU disponon edhe lejen zyrtare nga institucionet e tjera për pedagogët e angazhuar me kohë të pjesshme.</p> <p>Siç u përmend edhe më lart, AU ka dokumentacionin që dëshmon se personeli akademik rekrutohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara dhe të miratuara paraprakisht.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardi për rekrutimin, përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit akademik dhe ndihmës në funksion të programit të studimit që vlerësohet, përmbushet pasi AU dëshmon se ka një bazë rregullatore për rekrutimin, përzgjedhjen dhe vlerësimin e performancës. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" përbën 40% të personelit akademik. Kërkohet që të përmirësohet ky raport në mënyrë që 70% e personelit të jetë i punësuar me kohë të plotë. Gjithashtu kërkohet të plotësohet kërkesa që titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore "Doktor". Standardet për personelin përmbushen pjesërisht.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Albanian University ka një infrastrukturë bashkëkohore në funksion të përmbushjes së misionit të tij. AU ka mjedise të përshtatshme për zhvillimin e mësimit, të veprimtarive dhe të studimit. AU ka në dispozicion të studentëve bibliotekën dhe pajisjet e teknologjisë elektronike dhe dixhitale.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>AU ka vendndodhje të përhershme me auditorë dhe zyra për administratën. Këto mjedise janë shtuar në vijimësi.</p> <p>Programi i studimit që po merret në vlerësim i ofron studimet në një godinë.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>AU siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në disa mënyra: ka botimet e veta, ka libra në bibliotekë, ka bibliotekën on-line.</p> <p>Biblioteka ka gjithsej 138 tituj librash për fushën e psikologjisë.</p> <p>Ndonëse pedagogët dëshmuar se ata bëjnë për vit propozime për tituj librash, biblioteka nuk është pasuruar mjaftueshëm.</p> <p>Biblioteka ka orare shërbimi për studentët, por mjedisi i saj është i vogël. Mundësia për të përdorur burime të literaturës on-line garantohej vetëm në bibliotekë. Studentët raportuan se pedagogët u dërgojnë burime literature elektronikisht.</p> <p>AU duhet të investojë më shumë për krijimin e një biblioteke sipas</p>

	standardeve bashkëkohore, mbase një bibliotekë qendrore.
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka mjedise fizike të mjaftueshme, por studentët e programeve të psikologjisë u shprehën se ata do të donin një godinë më moderne dhe më funksionale.</p> <p>AU ka mjedise të pajisura me teknologji në funksion të mëimit.</p> <p>Në funksion të programit “Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik”përdoret një laborator informatike i cili i ndihmon studentët për të përmbushur detyrat që kanë në lëndët e ndryshme dhe për mikrotezën.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Albanian University ka një infrastrukturë përgjithësisht të mirë në funksion të plotësimin të misionit të programit “Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik”. Por nevojitet që biblioteka të pasurohet me tituj librash për psikologjinë, të ketë një mjedis më të madh dhe më modern. Gjithashtu, duhet të përmirësohet lidhja on line për studentët që ajo të jetë e arritshme për ta kudo që ata studiojnë. AU duhet të planifikojë ngritjen e një biblioteke moderne qendrore për universitetin. <u>Standardet për infrastrukturën duhet të përmirësohen lidhur me bibliotekën.</u></p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

AU ndjek procedura financiare sipas legjislacionit në fuqi dhe kryen auditin financiar për çdo vit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU përgatit për vit raportin e auditit për analizën e buxhetit për realizimin e programeve të studimit. Këtë raport e disponon Zyra e financave e AU.</p> <p>Institucioni i ka të dokumentuara raportet financiare për të tre vitet e fundit. AU nuk ka patur grante të huaja. Të gjitha shpenzimet për programin janë mbuluar nga burime të vetë universitetit.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raportin vjetor në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat dhe shpenzimet. Ky raport disponohet nga zyra e financave të universitetit. Institucioni i ka të dokumentuara raportet financiare për të tre vitet e fundit ku dëshmohet se nuk ka ndonjë grant të huaj si përfitim.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka burime financiare të mjaftueshme të cilat janë pasuruar nga rritja e numrit të studentëve dhe programeve të studimit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Informacioni financiar i AU dëshmon se institucioni ka burime të qëndrueshme financiare të cilat kanë ardhur duke u shtuar vitet e fundit. EVJ konstatoi që AU bën një raport tërësor për të gjitha programet. Do të ishte më e efektshme që raportimi financiar të kryhej për secilin fakultet dhe program, pasi në këtë mënyrë do të jepej një tablo reale për burimet, shpenzimet dhe parashikimin financiar për secilin program. <u>Standardet për financimin plotësohen.</u></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

AU e ka institucionalizuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Për realizimin e objektivave për sigurimin e cilësisë është ngritur Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionon si një organizëm i përbërë nga 3 punonjës. Ky organizëm monitoron dhe vlerëson veprimtarinë e njëjësive bazë të institucionit dhe performancën e personelit. Objekt i veprimtarisë së ZSBC është edhe përmirësimi i cilësisë së kurrikulave dhe të mësimdhënies. Kontributet të spikatura të ZSBC lidhen a) me sigurimin e cilësisë së programeve lëndore, të mësimdhënies dhe të personelit; b) me menaxhimin e vlerësimit të brendshëm të institucionit dhe të programeve; c) me vlerësimin e studentëve për personelin akademik dhe administrativ.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>AU ka një Zyrë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e cila është përgjegjëse për të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë. Kjo zyrë ka përgatitur instrumentet për të matur cilësinë, si formularë vlerësimi për studentët, pedagogët dhe drejtuesit, pyetësorë për studentë për cilësinë e vlerësimit, format raporti vlerësimi për fakultetin, departamentin, pedagogët.</p> <p>AU e ka përfshirë informacionin e mbledhur nga raportet e vlerësimit në raportin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Institucioni i ka publikuar rezultatet e vlerësimit të brendshëm vetëm për pedagogët individualisht. Nuk ka praktikuar publikimin e raporteve të vlerësimit për informimin e studentëve, pedagogëve dhe publikut në faqen e internetit të AU ose nëpërmjet një buletini të përvitshëm të cilësisë.</p> <p>AU ka përdorur disa metoda për vlerësimin e cilësisë, sondazhe me studentë, sondazhe për vlerësimin e mësimdhënies, dhe rezultatet nga provimet, raportet e departamentit, të FSHSH, vlerësimet e mikrotezave.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm ve që kërkohen.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>AU ka informuar individualisht pedagogët për vlerësimet e studentëve dhe të drejtuesve si dhe MAS sipas formularëve të kërkuar për cilësinë,</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>ndërsa nuk janë praktikuar buletine ose broshura ose informacione në faqen e internetit të institucionit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>AU përgatit raporte vjetore ku përfshin edhe sigurimin e cilësisë. AU nëpërmjet zyrës së kurrikulave ka hartuar politika për përmirësimin e cilësisë së programeve mësimore. Sipas kësaj politike programet rishikohen në fillim të viti akademik dhe miratohen ndryshimet e propozuara brenda kufirit të lejuar të ndryshimeve.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>AU është në proces për akreditimin institucional.</p> <p>AU ka krijuar një paketë me instrumente për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo paketë përmban formularë vlerësimi, pyetësorë, pyetje për intervista, formate raportesh për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>AU ka përcaktuar procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë të cilat përfshijnë vlerësimin e programeve lëndore, vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e shërbimeve për studentët.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave kryejnë vlerësimin e herëpashershëm të programeve të studimit duke garantuar përditësimin e tyre dhe përmirësimin në masën e lejuar.</p> <p>AU ka kryer disa seanca trajnimi për personelin akademik dhe përfaqësuesit e studentëve lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, akreditimin si dhe rolet që mund të luajnë ata në kuadrin e procesit të vlerësimit të brendshëm, të jashtëm dhe të akreditimit.</p> <p>AU ka politika për përmirësimin e cilësisë. Politika e vlerësimit të cilësisë është bërë e njohur nëpërmjet aktiviteteve në kuadrin e sigurimit të cilësisë. Nuk janë përdorur forma të tjera.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: AU ka ngritur dhe ka institucionalizuar sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe e ka bërë vlerësimin pjesë integrale të veprimitarisë së tij. Ngritja e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përcaktimi i procedurave, përgatitja e instrumenteve, menaxhimi i</p>	

procesit të vlerësimit të brendshëm, trajnimi i personelit dhe i studentëve për të përmbushur rolin e vlerësuesit janë tregues që dëshmojnë për një sistem vlerësimi veprues. Rekomandohet që rezultatet e vlerësimit për programet e studimit, lëndët mësimore dhe mësimdhënien t'u bëhen të njohura edhe studentëve në mënyrë që ata të shohin ndryshimet dhe përmirësimet e rekomanduara dhe të jenë më të përgjegjshëm dhe të motivuar për rolin e vlerësuesit. Gjithashtu rekomandohet që të përdoret vlerësimi nga kolegët. Rekomandohet që përveç formave të përdorura, të publikohet informacion për sigurimin e cilësisë nëpërmjet një buletini dhe në faqen zyrtare te internetit të AU. **Standardet për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë përmbushur.**

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" synon të ofrojë një formimim të specializuar në këshillim ppsikologjik dhe të mundësojë një karrierë të suksesshme në shërbimin e këshillimit psikologjik dhe të kërkimeve në këtë fushë. Ky program studimi është ndërtuar në përputhje me kërkesat për elementet e planit mësimor, për ngarkesën mësimore të shprehur në kredite, për raportet ndërmjet lëndëve në planin mësimor, për programet e lëndëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Në Planin mësimor jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, 1 kredit llogaritet me 25 orë.
- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Aneksi 6)
- Nuk konstatohet ndryshim në planet mësimore që nga koha e hapjes së programit.
- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
 - Për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën lëndore 20-25 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën Profesionale 300 orë në institucion
 - Provimi përfundimtar 750 orë punë e pavarur e studentit
- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementet e tyre, për çdo lëndë
 - Programet mësimore për çdo lëndë përbajnë të gjithë elementet e kërkuaa, si:
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

GVJ pati në dispozicion paketën e programeve lëndore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi 1.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" është licensuar me Urdhër Urdhër Nr. 498, datë 18.10.2012. Studimet vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
Standardi 1.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i</p>	<p>Programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" i pajis studentët me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe i aftëson për kërkim shkencor dhe veprimtari të mirëfilltë profesionale. Ka një sërë lëndësh të cilat i pajisin studentët me aftësi kritike e njohuri specifike mbi kërkimin shkencor në fushën e psikologjisë dhe njëkohësisht përthyerjen e tij në kontekstin e këshillimit psikologjik si dhe i aftësojnë të kryejnë kërkim shkencor në fushë.</p> <p>Siç theksohet edhe në Rregulloren e programit Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik, në nenin 5 të saj, programi i studimeve "Master i Shkencave" synon të pajisë me njohuri studentët me qëllim të formojë psikologë këshillimi të cilët të jenë të aftë të ofrojnë shërbimin më të përshtatshëm këshillimi për individët, grupet dhe institucionet.</p> <p>Kriteri 4: Fakulteti i Shkencave Shoqërore të AU nuk ofron programe të integruara.</p> <p>Kriteri 5: Programet lëndore të këtij programi studimi i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen</p>

<p>Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ato shprehen qartë në secilin program lëndor.</p> <p>Kriteri 6: Programi i studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor. Kjo shprehet qartë në Rregulloren e studimeve.</p> <p>Kriteri 7: DPP që ofron programin e studimi të "Master i Shkenave në Këshillim Psikologjik" ka përcaktuar objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" i ka të përcaktuara qartë objektivat që synon të realizojë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato.</p> <p>Vlerësimi i studentëve realizohet nëpërmjet kontrollit të vazhduar dhe provimit të lëndës.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit që vlerësohet është mbështetur në analizën e programeve të universiteteve të huaja me përvojë të gjatë në fushë. Pedagogët që kanë studiuar jashtë vendit kanë sjellë përvojën e vendit ku kanë studiuar. Përvoja e huaj është përshtatur për kontekstin vendor. AU dëshmon se janë përdorur standardet dhe kriteret e EuroPSY, standarde të kualifikimit evropian për psikologët.</p> <p>Programi i studimit që vlerësohet përmban elemente të njëjta me programet që ofrohen në vendet evropiane, si: kreditet, rubrikat e programeve lëndore, metoda të vlerësimit, literaturë, provë finale, etj). Në fund të diplomimit, krahas diplomës, studentët pajisen me Suplementin e diplomës (hartuar sipas modelit evropian).</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me direktivat e Procesit të Bolonjës të cilat janë zbatuar në Shqipëri.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkenave në Këshillim Psikologjik" përveç anës teorike dhe aftësimi praktik, realizon edhe aftësimin për kërkim që kryhet nëpërmjet një lënde të kërkimit shkencor në psikologji këshillimi, nëpërmjet aftësimi kërkimor në të gjitha lëndët e kurrikulës dhe nëpërmjet</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>përgatitjes së tezës së diplomës. Studentëve u ofrohet mundësia që të mund të paraqesin punën kërkimore shkencore edhe në konferencat që organizohen çdo vit akademik në rang fakulteti, por edhe të botojnë artikuj në bashkëpunim me udhëheqësin e tyre shkencor në revistën shkencore të AU "Optime".</p> <p>Programi i studimit që vlerësohet hartohet në përputhje me strategjinë e AU.</p> <p>Siç dëshmuar pedagogët dhe studentët, pedagogët i pasqyrojnë kërkimet e tyre në mësim dhe kërkimet e tyre përputhen me fushat që mbulon programi.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Ky standard nuk aplikohet për masterin e shkencave që vlerësohet.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkomëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" mban parasysh nevojat e tregut të punës i cili kërkon psikologë këshillimi të cilët i kanë munguar Shqipërisë.</p> <p>AU nuk dëshmon se ka kryer ndonjë studim të posaçëm për mundësitë e punësimit në tregun vendas dhe rajonal, të ketë të dokumentuara kërkesat e punëdhënësve. Por ka një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" përputhet me interesat kombëtare dhe mbështet ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare nëpërmjet përmbajtjes së programeve lëndore, literaturës që përdor dhe nëpërmjet rasteve të studimit që përdoren.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" realizohet me 120 kredite, me kohëzgjatje në dy vite akademikë. Për tezën e kërkimit janë parashikuar 30 kredite.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Informacioni për programin e studimit, programet mësimore të lëndëve, literaturën është vënë në dispozicion të studentëve që në fillim të çdo semestri. Studentëve u jepet nga secili pedagog programi mësimor i lëndës, burimet e literaturës në mënyrë elektronike dhe të gjitha sqarimet lidhur me detyrat dhe vlerësimin. Këtë e dëshmuuan studentët dhe pedagogët gjatë takimeve që GVJ zhvilloi me ta.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Procedura e diplomimit përshkruhet në Rregulloren e programit të studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik"</p> <p>Për tezën e kërkimit janë parashikuar 30 kredite.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardet për politikën e studentëve plotësohen pasi programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të AU, me misionin e AU, në përputhje me nivelin e studimeve, me kërkesat e tregut të punës, respekton dimensionin evropian, ka të parashikuar kreditet e kërkuara për kërkimin shkencor, vë në dispozicion</p>	

informacionin e nevojshëm për ecurinë e studimeve dhe të diplomimit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion konstatuam se për realizimin e programit që vlerësohet përdoren metoda bashkëkohore të mësimdhënies që kanë në qendër studentin, përdoret teknologji bashkëkohore, përdoret interneti, filma, DVD mësimore.

DPP, në fillim të vitit akademik bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas rregullave të AU dhe duke mbajtur parasysh specializimin e secilit pedagog.

Vlerësimi i studentëve realizohet sipas politikës së vlerësimit të AU e cila parashikon vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përmbledhës. Mënyra e vlerësimit është pasqyruar në programet mësimore të lëndës.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohet nëpërmjet vlerësimit të studentëve dhe vlerësimit të drejtuesve të fakultetit. Vlerësimi i studentëve kryhet në çdo semestër nëpërmjet një formulari vlerësimi. Ndërsa drejtuesi i DPP dhe i FSHSH përgatisin raporte ku përfshijnë edhe vlerësimin e mësimdhënies.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedurat e pranimit të studentëve. AU ka një politikë të pranimit e cila zbatohet edhe nga DPP për programin e marrë në vlerësim. Pranimi në këtë program studimi bëhet me konkurrim nëse numri i kërkesave është më i madh se kuota e pranimit. Procesi i përzgjedhjes organizohet sipas rregullores së organizimit të programit të studimit dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese të këtij programi.

Cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite: Në vitin akademik 2012 – 2013 numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi ka qenë 6, mesatarja e tyre hyrëse ka qenë 7.6. Në vitin e dytë të këtij programi vazhduan studimet 4 studentët ndërkohë që 1 u largua dhe tjetri ishte mbetës pasi nuk kish përmbushur detyrimet.. Për vitin akademik 2013- 2014, nuk ka pasur studentë të rinj të regjistruar në këtë program studimesh. Gjithashtu, në vitin akademik 2014-2015 dhe 2015-2016 nuk ka patur regjistrim studentësh në këtë program.

Koha e zgjatjes së studimeve në këtë program është dy vite akademike, katër semestra. Brenda këtyre semestrave përfshihen si forma mësimore leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat mësimore, specializimet, kualifikimet, kërkimi shkencor dhe angazhime të tjera akademike.

Kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të. Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Kur studentin ka frekuentuar më pak se 50% të seancave të parashikuara në kurrikul, humbet të drejtën të shlyejë provimin përkatës jo vetëm në sesionin e rregullt të provimeve, por edhe në sesionet e ripërsëritjes. Ai është i detyruar që ta rifrekuentojë lëndën përkatëse.

Statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve. Në këtë program, deri tani janë diplomuar 4 studentë dhe nota mesatare e tyre rezultoi të ishte 9. Nuk ka ndonjë statistikë për punësimin e të diplomuarve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Në programin "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" pranohen studentët që zotërojnë Diplomë Bachelor ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të.</p> <p>Pranimi i studentëve është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e AU.</p> <p>Studentët e këtij programi janë të detyruar të respektojnë kërkesën për dhënien e provimit të gjuhës angleze. Dëshmia e provimit gjendet në dosjet e studentëve.</p> <p>AU në kuadrin e politikës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerëson edhe politikën e pranimit të studentëve. Kjo dëshmohet nga raportet e DPP, FSHSH dhe e konfirmuar nga takimet me ZSBC dhe DPP.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>AU ka një Zyrë të Karrierës e cila i informon studentët për mundësitë e punësimit.</p> <p>Studentët mbahen të informuar për procedurën e akreditimit dhe për vlefshmërinë e diplomës që ofrohet nga AU në psikologji këshillimi.</p>

<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimit deri në diplomim.</p>	<p>Për programin "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" ka statistika për të diplomuarit.</p> <p>AU ka statistika për të diplomuarit për programet e studimit që kanë përfunduar.</p> <p>AU ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve nga pranimit deri në diplomim. Por vlerësuesi i jashtëm vërejt se nuk janë të dokumentuara në regjistrin e arritjeve vlerësimet negative me argumentin se nuk ka hapësirë të mjaftueshme në regjister.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>AU ka statistika për programet e përfunduara, përfshirë edhe programin që vlerësohet.</p> <p>AU ka të dhëna për studentët që vazhdojnë studimet në ciklet e ndryshme brenda AU. Këto të dhëna disponohen nga Sekretaria Mësimore.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit. Ky informacion jepet nga DPP, Sekretaria Mësimore dhe ZVBC.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Ky informacion jepet nga pedagogët dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p>Pedagogët diskutojnë me studentët rezultatet e vlerësimeve. Studentët u shprehën shumë të kenaqur me komunikimin e pedagogëve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet</p>	<p>AU ka një zyrë për karrierën e cila kryen këshillimin e studentëve për çështje të karrierës.</p>

<p>zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardet lidhur me mësimdhënien dhe informimin e studenëve plotësohen. Në përmbushje të këtyre standardeve DPP zbaton politikën e mësimdhënies, të vlerësimit dhe të informimit të AU që është pasqyruar në Dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit, në Rregullore, në politikën e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Lidhur me dokumentimin e arritjeve u konstatua se AU nuk ka të dokumentuar vlerësimet negative në regjistrin e arritjeve, gjë që u kërkua të reflektohet menjëherë.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

AU e ka të përfshirë në politikën e zhvillimit komponentin e kërkimit shkencor. Në këtë kuadër janë zhvilluar konferenca shkencore, seminare për çështje të psikologjisë. AU boton revistën "Optime" e cila përmban artikuj shkencorë. Në kuadër të politikës së kërkimit, janë bërë përpjekje për të përfshirë edhe studentët në veprimtari kërkimore, por këto janë ende të pakta.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik publikon artikuj shkencorë në revistën e AU "Optime" dhe revista të tjera jashtë dhe brenda vendit. Personeli akademik nëpërmjet kërkimit shkencor jep kontribut në trajtimin e çështjeve psikologjike.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Në programin e marrë në vlerësim, mësimi nuk ofrohet në gjuhë të huaj, por pedagogët dëshmojnë se zotërojnë gjuhë të huaja.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>AU ofron mundësi për kualifikim të personelit akademik nëpërmjet seancave të trajnimit dhe programeve të doktoraturës për personelin e ri. Seancat e kualifikimit janë zhvilluar për kurrikulat, për hartimin e programeve lëndore, për mësimdhënien interaktive, për vlerësimin e studentëve, për vlerësimin e brendshëm dhe akreditimin, për kurrikulat e mbështetura mbi kompetencat.</p> <p>AU ofron mbështetje për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik si brenda ose jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>DPP ka të dhëna për veprimtarinë kërkimore të pedagogëve të angazhuar në programin që vlerësohet. Të dhënat përfshijnë pjesëmarrjen në konferenca, botimin e artikujve dhe të librave, pjesëmarrjen në projekte brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardet për kërkimin shkencor plotësohen pasi AU ka një politikë të kërkimit, ka të dhëna për veprimtarinë kërkimore të personelit akademik, ka zhvilluar konferenca, boton revistën shkencore "Optime", ka mbështetur kualifikimin e personelit akademik brenda dhe jashtë vendit.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete brenda dhe jashtë vendit. Janë të konkretizuara disa marrëveshje bashkëpunimi me universitetet në disa vende të botës. Këto bashkëpunime janë parashikuar të ndikojnë në njohjen e ndërsjellë të kulturave, për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta, për të rritur cilësinë e mësimit dhe të kërkimit, për të rritur mobilitetin e personelit akademik për programet e doktoratës në veçanti.

Në kuadër të marrëveshjes, që Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka kryer me Universitetin e Palermos, për programin e studimeve doktrale, është mundësuar ligjërimi i pedagogëve të këtij universiteti në programin e doktoratës të ofruar në psikologji.

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese	
1	Universiteti "Luigj Gurakuqi"
2	Drejtori i Autoritetit Shëndetësor
3	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit
4	Gjykata e shkallës së Parë për krimet e rënda
5	Gjykata e rrethit gjyqësor, Tiranë.
6	Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve
7	Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
8	Prefekti i Qarkut Tiranë
Organizatat Profesionale	
1	Fshati SOS
2	Sot për të Ardhmen
3	Pink Embassy
4	Aksion +
5	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
6	Kryqi i Kuq Shqiptar
7	Qendra e shëndetit Mendor "Shtëpia e Kuqe"
8	Shoqata "Në dobi të gruas shqiptare"
9	Komuniteti Emanuel
10	Aleanca Gjimore për zhvillim
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	
1	Klinikë private e shëndetit mendor "Venis"

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>AU ka nënshkruar marrëdhënie bashkëpunimi për realizimin e praktikës profesionale. Lista e institucioneve me të cilat bashkëpunon AU për praktikat profesionale është paraqitur më lart.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU ka përvojë të mirë në bashkëpunimin e personeli akademik dhe administrativ për shkëmbimin e informacionit. Kjo u konfirmua në takimet që VJ zhvilloi gjatë vizitës në AU.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU dëshmon se ka bashkëpunime me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në funksion të realizimit të misionit të programit të marrë në vlerësim. Kjo dëshmohet nëpërmjet dokumenteve të marrëveshjeve dhe veprimtarive të zhvilluara.</p> <p>AU bashkëpunon me institucionet ku kryejnë praktikën studentët e psikologjisë si për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës, ashtu edhe për mundësitë e punësimit të studentëve.</p> <p>Në raportin vjetor FSHSH paraqet edhe çështje që lidhen me zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardet për bashkëpunimin me institucione brenda dhe jashtë vendit në funksion të realizimit të programit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" plotësohen. Kjo dëshmohet me marrëveshjet e bashkëpunimit, me realizimin e praktikave në institucione të ndryshme brenda vendit, me informacionin për studentët dhe me analizat për ecurinë e bashkëpunimeve.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Nga analiza e mësipërme rezulton kjo pamje që shprehet nëpërmjet analizës SWOT:

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik", Universiteti Privat Albanian University

Pikat e Forta	Pikat e dobëta
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit "MSH në Këshillim Psikologjik" është një program bashkëkohor që merr në konsideratë si përvojën e vendit ashtu dhe edhe atë ndërkombëtare. 2. Personeli akademik që është angazhuar në programin "MSH në Këshillim Psikologjik" është cilësor me tituj dhe grada dhe ka krijuar premisa për një cilësi të mirë të mësimdhënies dhe kërkimit. 3. Koordinimi i teorisë me praktikën. Përmes gërshetimit të teorisë me praktikën, programi "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik" ofron një mundësi shumë të mirë përgatitjeje profesionale të të diplomuarve. 4. Komunikimi i efektshëm, profesional dhe transparent dhe ndërveprimi i pedagogëve dhe i autoriteteve drejtuese me studentët ka ndikuar në mënyrë pozitive në përmbushjen e misionit të programit. 5. Institucionalizimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet zyrës përkatëse mundëson monitorimin dhe garantimin e cilësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti pedagog me kohë të plotë dhe pedagog me kohë të pjesshme është në favor të pedagogëve me kohë të pjesshme. • Shumica e titullarëve të lëndëve nuk kanë gradën shkencore "Doktor", por janë në proces për fitimin e saj. • Mosdokumentimi në regjistrin e arritjeve të rezultateve negative të studentëve. • Angazhimi i pakët i studentëve në veprimtarinë kërkimore të departamentit dhe të universitetit. • Biblioteka ka një numër të kufizuar titujsh për psikologjinë dhe infrastrukturë që nuk është fort funksionale. • Informimi për sigurimin e cilësisë është i kufizuar për studentët dhe publikun.
Mundësitë	Pengesat
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa e vazhdueshme e tregut për specialistë me gradën master në psikologji. • Ofrimi i bashkëpunimit të universiteteve të huaja. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregu i kufizuar i fushës.

Rekomandime

1. Të përmirësohet raporti pedagog me kohë të plotë dhe pedagog me kohë të pjesshme në favor të pedagogëve me kohë të plotë.
2. Të plotësohet kriteri për titullar lënde me gradën shkencore "Doktor".
3. Të dokumentohen në regjistrat e arritjeve të gjitha rezultatet e provimeve, riprovimeve dhe përmirësimeve të studentëve.
4. Të investohet për modernizimin e infrastrukturës së bibliotekës, për pasurimin e bibliotekës me libra nga fusha e psikologjisë së këshillimit dhe për funksionimin efektiv të bibliotekës elektronike.
5. Të hartohet një strategji dhe plan veprimi për angazhimin më të madh të studentëve në veprimtari të ndryshme kërkimore.
6. Të hartohet një strategji dhe plan veprimi për të informuar personelin akademik dhe administrativ, studentët dhe publikun për sigurimin e cilësisë së programit "MSH në Këshillim Psikologjik" duke përdorur forma të shumëllojta.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik", Universiteti Privat Albanian University

ANEKSI 1 Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Departamenti i Pedagogjisë së Përgjithshme					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	18	2/6	16	5/6	35	7/12

ANEKSI 2

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave Sociale Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1 Erlehta Mato	Profesor	Prof. Dr.	1 Et'hem Ruka	Prof. Dr.		
2 Dava Përlala	Profesor	Prof. Asoc.Dr.	2 Artemis Shehu	Prof. Asoc. Dr.	UT	
3 Brunilda Laboviti	Lektore	Dr.	3 Gentjan Vyshka	Prof. Asoc.Dr.		
4 Elisabeta Kafja	Përgjegjëse Departamenti	Dr.	4 Luan Veliqoti	Prof. Asoc. Dr.		
5 Ervin Kaçiu	Lektor	Dr.	5 Eltojon Halimi	Prof. Asoc. Dr.		
6 Hajri Mandri	Lektor	Dr.	6 Alment Muho	Dr.		
7 Jorida Xhafaj	Lektor	Dr.	7 Eglantina Dervishi	Dr.	UT	
8 Sonila Çaloalaj	Lektor	Dr.	8 Eralda Zhilla	Dr.	UT	
9 Desara Agaj	Lektore	Dr. në proces	9 Jonida Haxhiu	Dr.	ISHP	
10 Dritan Taulla	Lektor	Dr. në proces	10 Livia Nano	Dr.	UT	
11 Elona Mehmeti	Lektor	Dr. në proces	11 Ornela Zhilla	Dr.	UT	
12 Esmeralda Ismaili	Lektor	Dr. në proces	12 Arben Hoti	Dr. Në proces		
13 Irena Hysenaj	Lektor	Dr. në proces	13 Enilda Tapaj	Dr. Në proces		
14 Silva Ibrahimimi	Lektor	Dr. në proces	14 Miranda Doksani	Dr. Në proces		
15 Gejsi Ndoja	Lektore	MSc	15 Redina Balla	Dr. Në proces		
16 Ilir Dyrmishi	Lektor	MSc	16 Valbona Treska	Dr. Në proces		
17 Lorela Garuli	Lektore	MSc				
18 Artemis Bajaziti	Lektore	MSc				

ANEKSI 3

Tabela 3: Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Dava Përlala	Prof. Asoc.Dr.	Kryetar
Elisabeta Kafja	Dr.	anëtar
Dritan Taulla	Dr. Në proces	anëtar

ANEKSI 4

Tabela 4: Të dhënat e personelit sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Titulli	Dep 1		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	1	1/1
Profesorë të As.	1	4	1/4
Doktorë	6	6	6/6
Docentë	-	--	---
Pedagogë (pa tituj)	6	5	6/5
Asistentë me Ma	4	-	4/0
Asistentë pa Ma	---	--	--
Personeli Administrativ	3	-	3

ANEKSI 5

Tabela 5: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Elona Mehmeti	drejtuese	5 vjet
2	Leudita Docaj	specialiste	3 vjet
3	Sidita Coniku	specialiste	1 vit

ANEKSI 6

Tabela 6: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Viti I	Lëndë / Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Profil
					ECTS	Në auditor	P. e pavarur	Orë mësimore	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Teoritë e avancuara të këshillimit psikologjik	I	6	4	45	55	2	15	35							60	90	150		
2	Metodologjitë dhe metodat e kërkimit shkencor në këshillim psikologjik (moduli A)	I	6	4	45	55	2	15	35							60	90	150		
3	Këshillimi psikologjik në grup	I	8	5	45	80	3	30	45							75	125	200		
4	Këshillim psikologjik familjar dhe në çift	II	8	5	45	80	3	30	45							75	125	200		
5	Metodologjitë dhe metodat e kërkimit shkencor në këshillim psikologjik	II	6	4	45	55	2	15	35							60	90	150		

Viti II	Lëndë / Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione						Seminare			Laborator			Praktikë			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine	
					ECTS	Në auditor	P. e pavarur	Orë mësimore	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur					
1	Metodologjitë dhe instrumentet për këshillimin dhe orientimin akademik dhe karriere	I	6	4	4	45	55	2	15	35										60	90	150		
2	Nocione ligjore dhe çështje etike të këshillimit	I	6	4	4	45	55	2	15	35										60	90	150		
3	Këshillimi dhe ndërhyrje e shpejtë	I	6	4	4	45	55	2	15	35										60	90	150		
5	Praktikë profesionale në këshillimin psikologjik	II	6	10	6	150	10																150	
6	Diploma	I + II	30	30	30															30	720	750		
Totali			60	52	24	465	185	6	45	95										210	990	1500		

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit "Master i Shkencave në Këshillim Psikologjik", Universiteti Privat Albanian University

ANEKSI 7

Tabela 7: Plani mësimor dhe personeli akademik përkatës

Tabela 13

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët	Titulli/grada Kualifikimi	Departamenti përgjegjës	PAE apo PAK
Matje dhe vlerësim në këshillim psikologjik	Lediana Xhakollari	Dr.	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Këshillim psikologjik individual	Anila Sulstarova / Besjona Dede	Dr/ Dr.proc	Psikologji e Përgjithshme	PAK/PAE
Teoritë e avancuara të këshillimit psikologjik	Irena Hysenaj	Dr. proces	Psikologji e Përgjithshme	PAE
Këshillim psikologjik në grup				
Intervista klinike në këshillim psikologjik	Anila Sulstarova	Dr.	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Nocionet ligjore dhe çështje etike të këshilluesit psikologjik				
Supervizim	Miranda Doksani	Dr.proc	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Metodologjitë dhe metodat e kërkimit shkencor në këshillim psikologjik	Dritan Taulla	Dr.proc	Psikologji e Përgjithshme	PAE
Këshillim familjar dhe në çift	Irena Shtraza	MSc	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Aftësitë dhe rolet e reja të këshilluesit	Florian Kulla	Dr.proc	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Këshillim dhe ndërhyrje e shpejtë	Eralda Zhilla	Dr.	Psikologji e Përgjithshme	PAK
Metodologjitë dhe instrumente për këshillim dhe orientim akademik dhe karriere	Elona Hasko	Dr.proc	Psikologji e Përgjithshme	PAE